



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:069453

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06328985

C.nr.96/23

Gjykata Themelore Gjakovë - Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësit I.K.nga fshati V., Komuna e Malishevës, të cilën me autorizim e përfaqëson Av. Agron Kryeziu nga Malisheva, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim i shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 21.10.2024 muar këtë:

A K T G J Y K I M **PËR SHKAK TË PADËGJUSHMËRISË**

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses I.K.nga fshati V., Komuna e Malishevës.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, t'ia paguaj paditësit I.K.në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën nga data 05.01.2022 deri më datë 22.11.2022 për 198 ditë të përlllogaritur nga 0.70 euro në çdo ditë pune në 70% të biletës t'ia paguaj shumën prej **138.60 euro**, të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës paditësve dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësja I.K.nga fshati V., Komuna e Malishevës, përmes të autorizuarit të saj Av. Agron Kryeziu nga Malisheva, në këtë gjykate ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, sipas padisë paditësi është i punësuar në Institucionin Parashkollor “Z.E” në Malishevë, sipas kontratës së punës dhe e cila ka 6 vite përvojë të punës, e cila dëshmohet përmes kontratës së punës, vërtetimit dhe listës së pagës, duke kërkuar nga gjykata ta njeh dhe ta realizon këtë të drejtë, gjykatës i ka propozuar që të aprovojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke e

detyruar të paditurën që paditësit ti kompenzojë për periudhën për vitin 05.01.2021 deri më datë 22.11.2022, për 198 ditë $x 1 = 198 - 30\% = 138.60$ euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumë prej 21 euro.

Gjykata në bazë të nenit 150 të Ligjit për Procedurën Kontestimore konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmëris.

Gjykata në kuptim të nenit 394, 395 al.1 dhe 2 të Ligjit të procedurës Kontestimore si u cek më lart i ka dërguar të paditurës padinë, provat materiale dhe aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi.

Duke e bërë shikimin në fletë dërgesë për dorëzimin personal konstatohet se me datë 15.03.2024, e paditura gjegjësit avokati publik i saj personalisht e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi të datës 14.03.2024, së bashku me padinë dhe provat materiale, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjigjes në padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj duke u bazuar në dispozita ligjore të nenit 150 al.1 pika (a),(b) dhe (c), të LPK-së të lartë cituar, Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet si më poshtë vijojnë:

- a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregull padia, provat materiale dhe thirrja-Aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi,
- b) Themelësia e kërkesë padisë rezulton nga faktet e treguar në padi, dhe
- c) Faktet mbi të cilat mbështet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.
- d)

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: Vërtetimin mbi përvojën e punës nr.518/22 të datës 24.11.2022 , Vërtetimin e lëshuar nga NTT “Korabi Tours”.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, ndërsa kontestuese mes palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë e drejta në kompensimin e plotë në emër të kompenzimit të shujtave, andaj nga provat e administruara si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas nenit 35 par.7 në të cilën përcaktohet se **“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”**,

Sipas nenit 8 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”** ndërsa në dispozitat e nenit 245 parg.1 të LMD-së, ka paraparë se **“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”**, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se **“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”**.

Nga provat e shqyrtuara gjykata ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 150 i LPK-së për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të pa dëgjueshmërisë, për faktin se e paditura edhe pse ka pranuar aktvendimin mbi dhënien e përgjigjes në padi dhe është njoftuar mbi pasojat e mos dhënies së përgjigjes në padi në bazë të nenit 395 par.2 të LPK-së të njëjtën nuk e ka ushtruar.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifatat e Avokatëve, duke detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguajë dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 150 , dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 90 parg.5 të Ligjit të Punës lidhur me 35.7 e Kontratës Kolektive Arsimit.

Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.96/23 me datën 21.10.2024

G j y q t a r i
Nehat Qelaj

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.